



## Udhëzim për grumbullimin e diferencuar të mbeturinave


Në Venezia dhe Giudecca ndalohet rreptësisht braktisja e qeskave me mbeturina në rrugë:

- **çojini qeskat** me mbeturina dhe me mbeturinat e diferencuara sipas ditës së përcaktuar, **në pikat e grumbullimit, nga e hëna në të premte, nga ora 6.30 deri në orën 8.30;**
- ose, prisni që punëtori i pastrimit t'i bjerë ziles, për afërsisht midis orës 8.30 dhe 12.

**Informacione në aplikacionin falas Veritas Scoasse**

**Gjoba prej 167 euro për ata që braktisin mbeturinat ose nuk kryejnë grumbullimin e diferencuar të mbeturinave.**

### LETRA KARTON DHE TETRAKARTON të hënën, të mërkurën dhe të premten



**po** Gazeta, fletore, libra, zarfe, shirita, fotokopje, fleta, fletushka dhe libërtha prej letre; qese prej letre; kuti Tetrapak për pije dhe ushqime (lëng frutash, qumësht, verë, salcë dhe bishtajore); kutiza, kuti të mesme dhe kuti të mëdha kartoni; karton i valëzuar; karton për pica.

**Kujdes: letra e ndotur me ushqim ose me materiale të tjera nuk duhet përzierë me letrat.**

**NDALOHET PËRDORIMI I QESKAVE PLASTIKE PËR GRUMBULLIMIN E LETRËS DHE KARTONIT**

**jo** Letër e plastifikuar, kimike dhe e vajosur; letra dhe kartonë të ndotur me ushqim ose me substanca të tjera.

### XHAM PLASTIKË KANAÇE DHE METALE të martën, të enjten dhe të shtunën



**po** Shishe, vazo, enë mbajtëse prej xhami, plastikë, alumin dhe metal; kova dhe magje; tubo dhe tubete bosh; kanaçe; celofan, letër alumin dhe shirit mbështjellës i tejudkshëm; thasë, qeska, qese, qeska për pazar dhe rrjeta plastike; kuti dhe qeska për biskota, ëmbëlsira dhe patatina; pjata dhe gota plastike për një përdorim të vetëm pa mbetje ushqimore; bombola spray bosh; kapakë, kafaze dhe tapa. **Kujdes: materialet nuk duhet të përmbajnë mbetje ushqimi ose produkti.**

**jo** Porcelan, qeramikë dhe Pirex, gota xhami; kristali; pasqyra, lastra xhami, llamba dhe tubo neoni; lugë e pirunë plastike për një përdorim të vetëm; lodra dhe sende prej gome.

### PLEHRA TË MBETURA nga e hëna në të shtunë



**po** Mbetje të kuzhinës dhe teprica të ushqimit; lule të prera dhe bimë shtëpiake; peceta letre të ndotura; shtrija për kafshët e vogla shtëpiake; gomë; lecka të ndotura; letra të vajosura, të plastifikuar dhe kimike; kartonë tepër të ndotur për pica; lugë e pirunë plastike; pelena dhe peceta thithëse higjienike (Lines); gota xhami dhe kristali (nëse janë thyer, atëherë mbështillini në letra gazete); shiringa dhe gjilpëra me kapuç; qese për fshesat me korrent; sende të vogla prej druri; lodra të thyera pa përbërës elektrikë ose elektronikë; qeramikë, porcelan dhe deltinë e pjekur (baltë); kultura, gërrshërë dhe stilolapsa; kasete audio dhe video, floppy disk, cd.

**jo** Mbetje të rënda dhe inerte; letër, karton dhe Tetrapak; xham, plastikë dhe kanaçe.

### MBETJE TË RËNDA DHE TË VEÇANTA


**Ecomobile vetëm për banorët privatë**

*Përballë tregut të Rialto-s, nga e hëna në të shtunë (përfshirë ditët e pushimeve), orari 8-11 dhe 14-17*  
Tërheqje e mbeturinave të rrezikshme, baterive dhe grumbulluesve, kanaçeve me bojë, enëve bosh për vajin vegjetal për gatim, pajisje të vogla elektrike, për shembull mixer-a, ora me alarm, robotë kuzhine, tharëse flokësh, përbërës dhe aksesore informatikë.

**Prenotim i tërheqjes në shtëpi të mbeturinave me përmasa të mëdha**

Për të eliminuar mbetjet dhe sendet me përmasa të mëdha, ekskluzivisht me origjinë shtëpiake, mund të përdoret shërbimi në shtëpi, falas deri në një metër kub. Për të kërkuar takim:


- > sms në numrin 342.4112660 (duke treguar kodin e klientit që gjendet lart majtas në faturë, sendin që duhet eliminuar dhe adresën ku duhet kryer shërbimi);
- > e-mail a [voluminosi.venezia@gruppoveritas.it](mailto:voluminosi.venezia@gruppoveritas.it);
- > fax në numrin 041.7292045;
- > telefononi në numrin e gjelbër falas 800.811.333, nga e hëna në të premte, 8.30-12.30 (me përjashtim të ditëve pushim).




**Veritas**

[www.gruppoveritas.it](http://www.gruppoveritas.it)

 [@gruppoveritas](https://twitter.com/gruppoveritas)

 [gruppoveritas](https://www.instagram.com/gruppoveritas)

 [gruppoveritas](https://www.linkedin.com/company/gruppoveritas)

**Contact Center**

Nga e hëna në të premte 8.30-17

nga telefoni **800 466 466**

numri i gjelbër falas

nga celulari **041 9655530**

me koston e aplikuar nga operatori juaj